

URDHËR
Nr. 671, datë 10.12.2021

PËR DELEGIM KOMPETENCE

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës, të ligjit nr.9000 "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave", të pikës 2, të nenit 7, të ligjit nr.8678, datë 14.5.2001 "Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë", të ndryshuar, të neneve 28 dhe 29, të ligjit nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", si dhe pikave 2 dhe 3, të nenit 11, të ligjit nr.90/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore",

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të Ministrisë së Drejtësisë nga data 12.12.2021-14.12.2021, Zëvendësministrit të Drejtësisë, znj.Adea Pirdeni.
 2. Ngarkohet Zëvendësministri i Drejtësisë, znj.Adea Pirdeni, për zbatimin e këtij urdhri.
- Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I DREJTËSISË
Ulsi Manja